

SHEMBULLI THJESHTON ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR. 3, DATË 05.03.2010
“MBI SISTEMIN E VIDEO SURVEJIMIT NË NDËRTESA, LOKALE E AMBIENTE
TË NDRYSHME”, I NDRYSHUAR

konkretisht pika 4 që ka të bëjë me qëllimin e vendosjes së kamerave në ambiente të ndryshme të kontrolluesve.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në funksion të ushtrimit të detyrave funksionale, në zbatim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar ka realizuar inspektime në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, në një sërë institucionesh publike dhe private që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Rasti konkret i referohet kontrollit administrativ të ushtruar në një nga subjektet kontrollues që ushtrojnë veprimtari në fushën e arsimit.

Në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, përveç konstatimeve të tjera pranë këtij kontrolluesi u evidentua se:

“Ambientet e kontrolluesit ishin të pajisura me një sistem kamera vëzhgimi(CCTV)”.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se,

“Sistemi funksiononte në hyrjen e shkollës, oborrin e shkollës, korridore dhe auditore. Nuk kishte mbikëqyrje në zonat ku çmohen se ka privatësi të lartë, të tilla si, tualetet, dhomat e ndërrimit apo zyra të personelit administrativ”.

Përsa i përket vendosjes së sistemit të vëzhgimit (CCTV) në auditore Komisioneri vlerësoi në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe të pikës 4, të Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010, **“Mbi sistemin e video survejimit, në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”**, në të cilin shprehimisht thuhet:

4. Detyrimet e një kontrolluesi i cili operon me një sistem të kamerave regjistruese të video survejimit, janë:

a) Sistemi i kamerave regjistruese të video survejimit nuk duhet të teprojë ndërhyrjen në jetën private të individëve. Një sistem video regjistrimi në thelb mund të instalohet, nëse qëllimi nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër (një pronë, për shembull, mund të mbrohet nga vjedhjet me kyç).

- Rreth vendosjes së kamerave vëzhguese në auditore në ditë provimesh

se;

Ky sistem mund të aktivizohet vetëm në auditore me kapacitet të madh studentësh, ku është e pamundur ndjekja e ecurisë së provimit me mjete të tjera të mbikëqyrjes për arritjen e qëllimit për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit gjatë realizimit të testimeve, për të shmangur mundësinë e kopjimit nga ana e studenteve, etj.

Ndërsa, në ato raste kur ka një numër të menaxhueshëm studentësh për mbikëqyrje kjo mund të realizohet me mjete të tjera përveç CCTV, (si psh; me pjesëmarrje të dy tre pedagogëve) pasi, aktivizimi i kamerave në këtë rast është joproporcional.

Në këto kushte Komisioneri doli me rekomandim për kontrolluesin sipas të cilit:

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe pikës 4/a të Udhëzimit Nr.3, datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit, në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”,

“ kontrolluesi, nuk duhet të aktivizojë sistemin e kamerave për efekt kontrolli të mbarëvajtjes së procesit të provimeve, në kushtet kur kapaciteti i studentëve arrihet të kontrollohet nga stafi akademik që kontrolluesi disponon ose me mjete apo mënyra të tjera për arritjen e qëllimit”.

SHEMBULLI THJESHTON ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR. 3 DATË 05.03.2010 “MBI SISTEMIN E VIDEO SURVEJIMIT NË NDËRTESA, LOKALE E AMBIENTE TË NDRYSHME”

konkretisht pika 5/a që ka të bëjë me pozicionimin e kamerave në hyrje daljet e godinave të subjekteve publike dhe private.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në funksion të ushtrimit të detyrave funksionale në zbatim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar ka ndërrmarë një fushatë inspektimi dhe mbikëqyrje në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, në një sërë bankash që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

Përveç shkeljeve të tjera, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, u vunë re shkelje në lidhje me pozicionimin e kamerave në ambjentet hyrëse dhe dalëse të Godinave të bankave. Ne rastet ku u kontaktuan shkelje Komisioneri doli me Rekomandime përkatëse, ku midis të tjerash në lidhje me rastin ka arësytuar si më poshtë:

Komisioneri vlerëson shkelje të nenit 5 pika 1 germa “c” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, përmes përdorimit të sistemit me kamera CCTV në ambientet e jashtme, (trotuar, rrugë) ngjitur me godinën e tij.

Mbledhja e të dhënave personale (imazhet) të kalimtarëve të cilët nuk kanë lidhje me këtë kontrollues, është e tepërt lidhur me qëllimin për të cilin kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale (imazhe) nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV, duke qenë kështu në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenin 5 pika 1 germa “c” ..*të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim*”.
- Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”
- Rregulloren “*Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare*” (neni 10 pika “a”), miratuar me vendimin nr. 04 datë 19/01/2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Pa qenë subjekt i këtij përpunimi kalimtarët e rastësishëm automatikisht bëhen pjesë e këtij përpunimi i cili nuk ka për qëllim këtë kategori subjektësh. Ky lloj përpunimi është ndërhyrje në jetën private të kalimtarëve imazhet e të cilëve mund të përdoren në mënyrë abuzive për qëllime të tjera.

Vëzhgimi i fasadës është mëse i mjaftueshëm, nëse subjekti nga kalimtar i rastësishëm vendos të ndërmarrë sulme ndaj godinës, ambienteve dhe territoreve të kontrolluesit. Këto imazhe së bashku me imazhet e përpunuara nga sistemi i CCTV-se në ambientet e brendshme janë më se të mjaftueshme për të zhvilluar hetime në lidhje me identifikimin dhe marrjen e provave për kapjen e autorëve të krimeve që dëmtojnë kontrolluesin.

Pas këtij arësytimi Komisioneri ka rekomanduar:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative:

Në zbatim nenin 5 pika 1/c të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*” të nenit 10 shkronja “a” e Rregullores “*Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare*”;

- ***Ndalimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare brenda një afati prej 30 ditë.***
- ***Shkatërrimin e të dhënave personale të mbledhura dhe përpunuara nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtrohet veprimtari bankare dhe financiare brenda një afati prej 5 ditë.***

Pas këtij Rekomandimi subjektet kontrollues Bankat ku dhe është konstatuar kjo shkelje kanë reaguar menjëherë duke respektuar pikat e Rekomandimit të Komisionerit.